



Tribuna Channel
Besiana Hoti
Pronare
Prishtinë

Rasti Nr. 2019/19
Ref:1903/368/KPM/mf

VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2019/19 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për Tribuna Channel (Palë përgjegjëse)

Faktet

1. Pala përgjegjëse me seli në Prishtinë është pajisur me licencë të KPM-së me datën 15 qershor 2009. Pranimi dhe nënshkrimi i Licencës obligon të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin e KPM-së dhe me të gjitha aktet nënligjore të miratuara nga KPM.
2. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
3. KPM me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës përgjegjëse me Kodin e Etikës KKPM-2016/03, me datën 22 shkurt 2019 ka bërë monitorimin e programeve të këtij subjekti në lidhje me raportimet për abuzimin e një të miture, i njohur si rasti “Drenasi”.
4. Në bazë të Raportit të monitorimit KPM ka gjetur se Pala përgjegjëse gjatë transmetimit të materialeve në lidhje me rastin në fjalë, me 6 dhe 7 shkurt 2019, në edicionet e lajmeve qendrore ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03, duke zbuluar identitetin e personit të dyshuar, policit, përmes transmetimit të emrit të plotë si dhe fotografisë së tij.

Analiza Ligjore

5. Komisioni i KPM-së bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura gjen se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
6. Bazuar në monitorimin që i është bërë edicioneve të lajmeve qendrore vërehet se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, i cili përcakton se:

“OSHM-të respektojnë të drejtën e individit që të konsiderohet i pafajshëm derisa të mos vërtetohet fajësia nga gjykata kompetente.”

7. KPM ka gjetur se Pala përgjegjëse gjatë raportimit nuk i ka kushtuar kujdes mbrojtjes së identitetit të personit të përfshirë në rastin “Drenasi”, pasi ka transmetuar në mënyrë të plotë emrin dhe fytyrën e personit të dyshuar edhe përkundër faktit se institucionet e drejtësisë informatat për të dyshuarat i kanë dhënë në formë të inicialeve. Transmetimi në mënyrë të plotë i emrit dhe fytyrës së personit të dyshuar ende pa pasur ndonjë vendim të institucioneve të drejtësisë në lidhje me fajësinë e tij është përtej nevojës së informimit të publikut dhe dëmton integritetin e personave të përfshirë në këtë rast.
8. KPM ka gjetur se Pala përgjegjëse ka dështuar t’i kushtojë kujdesin e duhur mbrojtjes së identitetit dhe integritetit të personit të dyshuar, duke transmetuar emrin e plotë dhe foton e tij.
9. Prandaj, KPM duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka gjetur se Pala përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 7, paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Vendim

10. Pala përgjegjëse sanksionohet me Vërejtje në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 7, paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
11. Pala përgjegjëse obligohet që në të ardhmen t’i kushtojë kujdesin e duhur mbrojtjes së identitetit dhe integritetit të personave të dyshuar në mënyrë që të veprojnë në pajtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.

E drejta për Ankesë

12. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i Vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.

13. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Muja FERATI
Kryetar



29.03.2019
Datë